

Marrëveshje për Transferim të Pasurisë së Paluajtshme

Palët në këtë Marrëveshje janë:

- A AGJENCIA KOSOVARE E MIRËBESIMIT (“AKM”), organ i pavarur i krijuar në bazë të Rregullores së UNMIK 2002/12 datë 13 qershor 2002 Mbi krijimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (me ndryshimet e tanishme sipas Rregullores së UNMIK 2005/18), që vepron si kujdestare e Ndërmarrjes së identifikuar në Tabelën 1 më poshtë e cila është në proces likuidimi formal (“Ndërmarrja”); dhe
- B Personi ose entiteti i identifikuar në Tabelën 1 këtu si Transferim-marrësi (“Transferim-marrësi”)

Sfondi shpjegues dhe Qëllimi

- A AKM, në bazë të Neneve 8 dhe 9 të Rregullores së UNMIK Nr. 2002/12 datë 13 qershor 2002 Mbi krijimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK 2005/18), ka autoritetin të transferojë pasuri të paluajtshme të Ndërmarrjes.
- B Përmes një procesi tenderimi të hapur dhe me oferta publike e të vulosura, AKM zgjodhi Transferim-marrësin si oferta fituese për blerjen e pasurisë së paluajtshme të Ndërmarrjes.
- C AKM, duke vepruar si kujdestare në emër të Ndërmarrjes, ka rënë dakord të shesë disa pasuri të paluajtshme të Ndërmarrjes, dhe Transferim-marrësi ka rënë dakord të blejë pasuritë e paluajtshme në fjalë, mbi bazën dhe duke iu nënshtruar termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

TANI BIHET DAKORD për sa vijon:

1 Përkufizime dhe interpretime

- 1.1 Në këtë Marrëveshje (duke përfshirë edhe Tabelat), zbatohen përkufizimet e mëposhtme përveç kur konteksti kërkon ndryshe ose përveç rasteve kur parashikohet ndryshe:

“**Llogari bankare**” do të thotë llogaria bankare të AKM ku Transferim-marrësi ka depozituar shumën (në Euro) të barabartë me (1) çmimin e Shitjes minus (2) shumën e depozitës së paguar paraprakisht nga Transferim-marrësi, në përputhje me Rregullat e Tenderit;

“**Qira**” do të ketë kuptimin që i jepet këtij termi në Rregulloren e UNMIK Nr. 2003/13 të datës 9 Maj 2003 Mbi transformimin e të drejtës së përdorimit të Pronave të Paluajtshme Shoqërore, sipas ndryshimeve;

“**Pasuri**” do të thotë kolektivisht: (1) Pasuria e Paluajtshme dhe (2) pasuria e luajtshme, nëse ka, e listuar në tabelën 4 këtu.

“Çmimi i blerjes” do të thotë shuma e parave e specifikuar në Tabelën 1 të këtij dokumenti e cila është e barabartë me çmimin e ofertës që Transferim-marrësi paraqiti si ofertë për Pasurinë sipas procesit të tenderit sipas Rregullave të Tenderit;

“Pasuri e Paluajtshme” do të thotë disa parcela toke dhe çdo strukturë e ndodhur brenda kufijve të këtyre parcelave, për të cilën Ndërmarrja ka të drejtën e përdorimit ose ndonjë të drejtë tjetër pronësie, zotërimi ose përdorimi në përputhje me ligjin e zbatueshëm, detajet e të cilit janë paraqitur në një kopje të të dhënave kadastrale të parcelës e bashkëngjitur si Tabela 2 e këtij dokumenti;

“Rregullat e Tenderit” do të thotë Rregullat e Tenderit për shitje pasurie përmes një procesi ofertash konkurruese e të vulosura në bazë të të cilit Transferim-marrësi dorëzoi ofertën e vet për Pasurinë dhe në bazë të së cilës Transferim-marrësi u zgjodh si oferta fituese.

- 1.2 Interpretimi i kësaj Marrëveshjeje dhe tabelave të saj nuk cenohet nga ndonjë prej titujve të përdorur.
- 1.3 Dispozitat e Tabelave të kësaj Marrëveshjeje formojnë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

2 Kushtet për Transferimin e Pasurisë

- 2.1 AKM, duke vepruar si administratore në emër të Ndërmarrjes, transferon nga Ndërmarrja te Transferim-marrësi me anë të këtij dokumenti gjithë të drejtat dhe titullin e Ndërmarrjes mbi Pasurinë dhe interesin pasuror në Pasuri, duke iu nënshtruar ose duke gëzuar gjithë përfitimet dhe detyrimet e gjithë servituteve, të drejtave, marrëveshjeve, kufizimeve, licencave, qirave dhe obligimeve të tjera të çfarëdo lloji që ndikojnë Pasurinë dhe që ekzistojnë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë por pa u kufizuar te qiratë në lidhje me Pasurinë e Paluajtshme të parashtruara në Tabelën 1. Barrët apo ngarkesat e ndryshme nuk transferohen nëse shuhen sipas ligjit. Transferim-marrësi blen Pasurinë.
- 2.2 Në rast se qiratë transferohen sipas Tabelës 1, atëherë në masën që lejohet nga ligji, përfitimet e këtyre qirave, duke iu nënshtruar barrëve, i kalojnë transferim-marresit. Transferim-marrësi bie dakord se do të dëmshpërblejë plotësisht dhe do të ruajë mbrojtjen me dëmshpërblim ndaj AKM dhe NSH lidhur me të gjitha paditë, procedurat, kostot, pretendimet, dëmet dhe kërkesat kundër AKM ose NSH që lindin si pasojë e ndonjë shkeljeje në bazë të qirasë nga ana e Transferim-marrësit.
- 2.3 Transferim-marrësi bie dakord se pranon të drejtat dhe titullin e NSH mbi Pasurinë në gjendjen “siç është”, dhe në kushtet siç ishin në kohën e transferimit, dhe merr përsipër se nuk do të ngrejë asnjë pretendim kundër NSH dhe as AKM-së lidhur me çdo kusht të Pasurisë, ose të çdo faktori që ndikon Pasurinë, pavarësisht nëse ky kusht ose faktor është i hapur dhe i dukshëm, i vështirë për tu zbuluar pas një inspektimi të arsyeshëm ose i fshehur dhe i pamundur për të zbuluar. Pa paragjykuar përgjithësinë e fjalisë së mësipërme, Transferim-marrësi bie dakord se po blen Pasurinë (a) duke iu nënshtruar çdo lloj okupimi të Pasurisë dhe se po blen gjithë të drejtat që ka akumuluar NSH në lidhje me ndonjë okupim të paligjshëm ose të drejta pasurie të paregjistruara që ka NSH; dhe (b) pavarësisht nga fakti nëse janë ndërtuar struktura

mbi Pasurinë e Patundshme dhe/ose nëse ato janë regjistruar në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

- 2.4 Transferim-marrësi ka paguar çmimin e Blerjes në Llogarinë Bankare dhe i ka paraqitur AKM-së vërtetim të depozitës.
- 2.5 Kryerja plotësisht e transferimit të gjithë të drejtave dhe titullit të Ndërmarrjes dhe interesit në Pasurinë në fjalë do të konsiderohet se është kryer menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur përcaktohet ndryshe në ligjin e zbatueshëm.
- 2.6 Transferimi sipas Nenit 2.1 përfshin transferimin e gjithë të drejtave të Ndërmarrjes dhe titullit dhe interesave të Ndërmarrjes në strukturat e Pronës së Paluajtshme, përveç se kur shprehimisht përjashtohet në Tabelën 3 këtu, pavarësisht nga ndonjë mospërputhje mes strukturave që ekzistojnë aktualisht dhe strukturave që detajohen në regjistrat kadastralë të parcelave që paraqiten në Tabelën 2 këtu. Transferim-marrësi pohon dhe bie dakord se në rast se ndonjë strukturë në Pasurinë e Patundshme është ngritur në mënyrë që nuk përputhet me ligjin e zbatueshëm dhe procedurat, Transferim-marrësi nuk do të kërkojë pagesa të asnjë lloji nga AKM dhe NSH për këtë mospërputhje.

3 Parashtrësia dhe Garanci

- 3.1 Transferim-marrësi parashtron dhe i garanton AKM dhe Ndërmarrjes, se nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:
 - 3.1.1 është entitet juridik, (a) është entitet juridik rregullisht i korporatizuar dhe në gjendje të mirë në juridiksionin e korporatizimit, (b) ka fuqi të plota dhe autoritet për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e përmendura aty dhe (c) përfaqësuesi i tij sipas kësaj Marrëveshjeje ka autoritet të rregullt të ekzekutojë këtë Marrëveshje në emër të Transferim-marrësit;
 - 3.1.2 po blen pasurinë për përdorimin e tij dhe me vullnetin e tij dhe jo si agjent për palë të treta dhe, gjatë tenderit për Pasurinë, nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje joformale ose formale me asnjë ofertues tjetër ose me ndonjë palë të tretë të pazbuluar;
 - 3.1.3 ka marrë (a) dhe ka shqyrtuar çdo broshurë shitjeje ose dokument tjetër të përgatitur nga AKM e cila përshkruan Pasurinë dhe (b) AKM e ka këshilluar se ekziston një dhomë të dhënash në lidhje me Pasurinë dhe Ndërmarrjen (nëse ka) që përmban informata të rëndësishme në lidhje me Pasurinë dhe Ndërmarrjen (nëse ka) dhe i është dhënë mundësia të vizitojë dhomën e të dhënave dhe ose e ka kryer këtë vizitë në lidhje me Pasurinë dhe Ndërmarrjen ose ka vendosur të mos vizitojë atë. Pa paragjykuar dispozitat e mësipërme të këtij paragrafi, ai po ashtu konfirmon se ka shqyrtuar dokumentet e quajtura “Disa rreziqe ligjore dhe të tjera” në lidhje me Pasurinë dhe Ndërmarrjen, që ndodhen në dhomën e të dhënave;
 - 3.1.4 ka kryer shqyrtimin e duhur në lidhje me Pasurinë, Ndërmarrjen dhe regjimin ligjor në Kosovë siç e beson se është i duhur për qëllimin e blerjes të parashikuar nga Marrëveshja ku përfshihet por që nuk kufizohet te kontrolli i regjistrave publikë, vizitat dhe inspektimi i Pasurive dhe hetimi i

çështjeve si ndërtimi dhe leje të ngjashme dhe ndonjë formë e ligjshme ose e paligjshme (1) okupimi të Pasurisë (i përkohshëm ose tjetër) dhe (2) ndërtimi i strukturave të Pasurisë;

- 3.2 Pohon se shumica e ligjeve të zbatueshme në Kosovë janë shpallur vetëm kohët e fundit dhe për pasojë mund të ketë interpretime të ndryshme dhe janë të patestuara nga ana gjyqësore dhe për më tepër që regjistrat e Kosovës janë shpesh të paplotë dhe të paazhurnuar;

4 Titulli

- 4.1 Transferim-marrësi do të pranojë të drejtën dhe titullin e Ndërmarrjes dhe interesin e Ndërmarrjes në Pasuri dhe as AKM as Ndërmarrja nuk bëjnë ndonjë parashtrësë ose japin garanci lidhur me vlefshmërinë e këtyre të drejtave, titullit dhe interesit.

- 4.2 Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në masën që transferimi ose kalimi i ndonjë Pasurie nuk ka përfunduar, AKM do të konsiderohet se e mban këtë Pasuri nën administrim për llogari të Transferim-marrësit.

5 Të tjera

- 5.1 AKM (dhe AKM do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të prokuruar që Ndërmarrja) do të sigurojë ndihmesë të arsyeshme lidhur me dokumentet dhe informatat ndaj Transferim-marrësit, me shpenzimet e Transferim-marrësit, për të bërë efektive këtë Marrëveshje, brenda fushës së burimeve të kufizuara administrative të Ndërmarrjes dhe AKM.

- 5.2 AKM (dhe AKM do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të prokuruar që Ndërmarrja), me kërkesë të Transferim-marrësit, do të japë Transferim-marrësit ato lloj informatash të tjera dhe ndihmesë dokumentare që Transferim-marrësi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të realizuar një transferim efikas të të drejtave dhe titullit e interesit pasuror në Pasuri në favor të Transferim-marrësit.

- 5.3 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit, përveç rastit kur AKM përcakton se ratifikimi nga Bordi i AKM është i nevojshëm për hyrjen në fuqi të saj.

- 5.4 Pa paragjykuar ndonjë dispozitë tjetër në këtë Marrëveshje, secila Palë do të mbulojë taksat e veta dhe Transferim-marrësi do të mbajë gjithë përgjegjësinë dhe gjithë kostot për kryerjen e çdo regjistrimit që kërkohet me ligj lidhur me këtë transferim, ku përfshihet por që nuk kufizohet te regjistrimet në kadastër dhe merr përsipër të njoftojë autoritetet përkatëse (ku përfshihen edhe autoritetet e tatimeve).

6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1 Transferim-marrësi dhe AKM (secila, “**Palë**”, së bashku “**Palët**”) duhet të njoftojnë menjëherë Palën tjetër me shkrim (përfshi gjithë detajet) lidhur me çdo mosmarrëveshje që lind ose që lidhet me të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje ose shkeljes, vlefshmërisë ose ekzistencës së tyre. Brenda dhjetë (10) Ditësh Pune, AKM duhet të caktojë një afat dhe vend të arsyeshëm për mbledhjen e negociimit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në mirëbesim.

6.2 Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas njoftimit të mosmarrëveshjes:

- (a) Transferim-marrësi mund të depozitojë ankesë në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, me kusht që AKM të jetë njoftuar rregullisht në përputhje me Rregulloren e UNMIK 2002/12 (me ndryshimet sipas Rregullores së UNMIK 2005/18) dhe 2002/13.
- (b) AKM mundet në rolin e saj si ankues ose përgjegjës:
 - (i) të bëjë ankesë në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës; ose
 - (ii) Të kërkojë që mosmarrëveshja (duke përfshirë edhe kundër-padinë) ti referohet arbitrazhit në përputhje me Komisionin e Kombeve të Bashkuara mbi Rregullat e Arbitrazhit të së Drejtës ndërkombëtare të Tregtisë (“UNCITRAL”) siç është në fuqi dhe efektive në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Në rastin e këtij arbitrazhi, numri i arbitrave do të jetë tre (3), dhe secila Palë do të caktojë një (1) arbitër dhe këta dy (2) arbitra së bashku caktojnë së bashku arbitrin e tretë. Tribunali i arbitrazhit nuk ka të drejtën të marrë ose të japë, dhe Transferim-marrësi nuk ka të drejtën të kërkojë nga autoritetet gjyqësore, ndonjë formë mase mbrojtëse ose shpërblim para kohës së caktimit të ofertës fituese kundrejt AKM, pavarësisht nga dispozitat e UNCITRAL. Selia e arbitrazhit do të jetë Prishtina, Kosovë, dhe gjuha angleze do të përdoret gjatë gjithë kohës së procedurave të arbitrazhit. Palët bien dakord se arbitrazhi do të jetë mjeti përfundimtar dhe ekskluziv i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Rezultati i arbitrazhit i dhënë do të caktojë po ashtu ndarjen e shpenzimeve të arbitrazhit.

Dispozitat e Nenit 5.1.1 dhe 5.1.2 do të caktojnë forumet e vetme të Palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

6.3 Në pritje të zgjidhjes së ndonjë mosmarrëveshjeje, Palët duhet të respektojnë detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje pa paragjykuar përshtatjen përfundimtare në përputhje me rezultatin e caktuar në arbitrazh ose rastin e gjykatës që po zgjidh mosmarrëveshjen.

7 Të Përgjithshme

7.1 Marrëveshja e plotë. Kjo Marrëveshje dhe rregullat e zbatueshme të tenderit së bashku përbëjnë gjithë marrëveshjen mes Palëve në lidhje me çështjet e përmendura këtu dhe ka përparësi mbi marrëveshje ose masa të mëparshme mes Palëve ose çdonjërit prej tyre në lidhje me shitjen e Pasurisë dhe Palët bien dakord se nuk do të ngrihen pretendime në lidhje me asnjë marrëveshje ose masë që i është nënshtruar kësaj zgjidhjeje.

7.2 Ndarja. Në rast se secila prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga gjykata ose ndonjë autoritet tjetër kompetent, kjo

dispozitë do të quhet e fshirë nga kjo marrëveshje dhe dispozitat e mbetura të kësaj Marrëveshjeje mbeten në fuqi dhe efektive. Pavarësisht nga sa u tha më lart, Palët do të negociojnë në mirëbesim për të arritur marrëveshje mbi termat e një dispozite të kënaqshme për të dyja palët lidhur me dispozitën që konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme.

- 7.3 Mos-heqje dorë. Vonesat ose mosushtrimi nga ana e AKM e të drejtave, kompetencave ose privilegjeve sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të veprojnë për të penguar këto të drejta, kompetenca ose privilegje ose nuk do të interpretohet si heqje dorë prej tyre dhe asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm ose mos-ushtrimi i ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji nuk do të parandalojë në asnjë rrethanë ushtrimin e mëtejshëm ose të ndryshëm të tyre ose ushtrimin e çdo lloj tjetër të drejte, kompetence ose privilegji.
- 7.4 Nuk ka detyrime. Transferim-marrësi bie dakord se do të mbrojë personelin, zyrtarët, kontraktorët e pavarur dhe personelin e komanduar të lidhur me AKM nga çdo lloj dhe nga të gjitha llojet e detyrimeve të çdo lloji që lindin ose lidhen me humbjet ose dëmet që mund të mbulojnë nga Transferim-marrësi dhe pasardhësit e tij dhe personave përfitues të kalimit dhe çdo padi e Transferim-marrësit që lind sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të ngrihet ekskluzivisht ndaj AKM dhe/ose Ndërmarrjes.
- 7.5 Variacioni. Përveç se kur specifikohet ndryshe këtu, çdo lloj variacioni i kësaj Marrëveshjeje do të jetë i detyrueshëm vetëm në rast se regjistrohet në dokument të firmosura nga Palët.
- 7.6 Kosto. Secila Palë në këtë Marrëveshje do të paguajë shpenzimet e veta, detyrimet dhe kostot e duhura për përgatitjen, plotësimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të përmendura aty.
- 7.7 Gjuha dhe Kopjet. Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet në dy (2) origjinale në versionin e gjuhës angleze. Çdo version në ndonjë gjuhë tjetër i kësaj Marrëveshjeje do të ofrohet nga vullneti i mirë dhe nëse ka ndonjë mospërputhje mes versioneve të gjuhëve, versioni i gjuhës angleze të kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojë.
- 7.8 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin e zbatueshëm të Kosovës.
- 7.9 Njoftime. Adresa (dhe numri i faksit) për dhënien e njoftimeve AKM sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë siç parashtrohet më poshtë, dhe adresa (dhe numri i faksit) për dhënien e njoftimeve Transferim-marrësit do të jetë siç paraqitet në Tabelën 1 këtu, gjithmonë duke pasur parasysh që secila Palë mundet, duke i dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër, të zëvendësojë këtë adresë me një adresë tjetër ose numër tjetër faksi për dhënien e këtyre njoftimeve:

AKM

Adresa Postare: Nr. 8 Rruga Ilir Konushevc (Ish Kompaundi i Komunikacionit i Kombeve ë Bashkuara, UNCC) Prishtinë, Kosovë

Numër faksi: +381 38 248 076

Njoftimet mund të jepen duke dorëzuar dorazi njoftimin në adresën e personit të cilit i adresohet, ose me faks ose me korrier ndërkombëtar.

7.10 Pavlefshmëria e shitjes

Pavarësisht nga neni 10.5 i Rregullores së UNMIK Nr. 2002/13 ose dispozitave të tjera të ligjit të zbatueshëm, në rast se përcaktohet se (a) fondet e përdorura nga Transferim-marrësi për të blerë Pasurinë burojnë direkt ose indirekt nga aktivitete të paligjshme; ose (b) Transferim-marrësi ishte përfshirë në marrëveshje të fshehtë gjatë procesit të tenderit ose ndonjë shkelle tjetër të Rregullave të Tenderit, atëherë kjo Marrëveshje quhet e pavlefshme nga ana e AKM dhe shumat e depozitës së ofertës mbahen.

Përfaqësuesi i autorizuar sipas rregullit, i AKM-së, dhe Transferim-marrësi kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje në Kosovë.

AKM

Nga:

Titulli:

Datë:

Transferim-marrësi

Nga:

Titulli:

Datë:

Tabela 1

Deklaratë sipas Nenit 8.2 të Rregullores Nr 2004/2 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave ligjore të lidhura me të sipas ndryshimeve të Rregullores Nr 2004/10 dhe rregullores Nr 2005/9.

Ndërmarrja**Transferim-marrësi**

(Detajet përfshijnë adresën e njoftimeve dhe telefon/faks; identitetin e çdo personi ose entiteti që ka interes financiar në pasuri ose është përfitues i pasurisë që po transferohet, dhe natyrën e atij interesi pasuror ose statusin e beneficierit)

Detaje mbi Njoftimin e Shitjes Publike

Shitja me numër	
Numri i sendit	
Përshkrimi i Pasurisë dhe Vendndodhjes	

Çmimi i blerjes:**Mënyra e Pagesës:**

Llogaria Bankare e AKM ku është derdhur çmimi i blerjes:

Llogaria Bankare e Transferim-marrësit prej së cilës u krye pagesa:

Qiratë që po transferohen:

Për AKM:

**Për Transferim-
marrësin:**

TRANSFERIMET E PASURISË**Tabela 2 – Regjistri(at) e parcelave kadastrale**

- b. Parcelat e tokës së ndërmarrjes që mbahen nga Ndërmarrja përmes një të drejte përdorimi të paregjistruar mbi tokën në pronësi shoqërore ose përmes një forme tjetër të drejte përdoruesi, pronësie ose posedimi, të cilat po i transferohen Transferim-marrësit:

Lista e Posedimeve

<u>Zona kadastrale</u>	<u>Numër</u>	<u>Numri i parcelës</u>
------------------------	--------------	-------------------------

Ndërtesat:

Qëllimi i ndërtesës	Viti i ndërtimit	Materiali i ndërtimit	Sip. m ²

Vihet në dukje se edhe pse Ndërmarrja mund të jetë në pronësi, posedim ose kontroll të parcelës së mëparshme kadastrale ose mund të ketë të drejtën e përdorimit ndaj kësaj parcele kadastrale, kjo mund të mos jetë treguar saktësisht në regjistrat përkatës kadastralë. Për pasojë, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, **nuk mund** të krijohet një Marrëdhënie Qiraje për këto parcela kadastrale sipas Rregullores mbi Tokën pasi e drejta e përdorimit mbi këto parcela kadastrale nuk është e regjistruar në emrin e Ndërmarrjes në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

TRANSFERIME PASURIE

Tabela 3 –Strukturat që nuk transferohen bashkë me Pasurinë